



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Nr. 021/4 prot.

Tiranë më 13.6.2018

REKOMANDIM

Nr. 22, datë 13.6.2018

MBI

ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 a/1, dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë".

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 133, datë 04.05.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit "Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë" (MASR), me objekt kontrolli:

- Verifikimi i ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet formularit "Prindërit për çdo shkollë", në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Hetimi pranë këtij kontrolluesi u iniciua nga Zyra e Komisionerit bazuar në indiciet/ankesat, publikimet në median audio-vizive dhe atë të shkruar si dhe interesin publik që paraqet mbrojtja e të dhënave personale që përpunohen në kuadër të implementimit të projektit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për ndërtimin e databazës së të dhënave për kategoritë e subjekteve punonjës arsimore, prind, nxënës me qëllim organizim më efektiv të punës, rritjen e ndërveprimit dhe bashkëpunimit në kohë reale, me synim arritjen e rezultateve më të larta dhe përmirësimin e mëtejshëm të arsimit".

Me qëllim realizimin objektiv të hetimit administrativ, Zyra e Komisionerit ka urdhëruar kontrolluesin Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, DAR/ZA, të kryejnë bllokimin e

përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet formularit për projektin “Prindërit për çdo shkollë”, deri në momentin e përfundimit të hetimit administrativ të nisur nga Zyra e Komisionerit (Pika 4 e Urdhrit nr. 133, datë 04.05.2018).

1. Zyra e Komisionerit paraprakisht konstatoi se për krijimin e databazës dhe mbledhjen e të dhënave MASR ka hartuar dhe shpërndarë formularët si vijon:

- 1) “Komiteti i prindërve për çdo shkollë”;
Kategoritë e të dhënave që synohen të mblidhen nëpërmjet këtij formulari janë:
Numri personal i identifikimit, Emër, Mbiemër, Qarku, Bashkia, DAR/ZA, Shkolla, Telefon, Email.
- 2) “Prindërit për çdo shkollë”;
Kategoritë e të dhënave që synohen të mblidhen nëpërmjet këtij formulari janë:
Numri personal i identifikimit, Emër, Mbiemër, Qarku, Bashkia, DAR/ZA, Shkolla, Telefon, Email.
- 3) “Lista e drejtuesve të shkollave”;
Kategoritë e të dhënave që synohen të mblidhen nëpërmjet këtij formulari janë:
Numri personal i identifikimit, Emër, Atësi, Mbiemër, Qarku, Bashkia, DAR/ZA, Shkolla, Lloji i institucionit, Gjinia, Datëlindja, Telefon, Email.
- 4) “Lista e punonjësve për çdo DAR/ZA”;
Kategoritë e të dhënave që synohen të mblidhen nëpërmjet këtij formulari janë:
Numri personal i identifikimit, Emër, Mbiemër, Qarku, Bashkia, DAR/ZA, Telefon, Email.

Sa i përket formularëve “Komiteti i prindërve për çdo shkollë” dhe “Prindërit për çdo shkollë”, konstatohet se të dhënat e mbledhura janë të dhëna që kontrolluesi i disponon aktualisht në bazë të aktivitetit ligjor që realizon në fushën e arsimit, me përjashtim të kategorisë së të dhënave “numër personal i identifikimit”.

Zyra e Komisionerit vlerëson se për të dhënat personale të mbledhura për kategorinë “Prind/Kujdestar ligjor”, përveç informimit paraprak është i nevojshëm pëlqimi në lidhje me mbledhjen e kësaj kategorie të dhënash.

Gjithashtu, përsa i përket formularëve, “Lista e drejtuesve të shkollave” dhe “Lista e punonjësve për çdo DAR/ZA”, edhe në këtë rast, konstatohet se kontrolluesi i disponon këto të dhëna në kuadër të marrëdhënies së punësimit, që e legjitimon procesin e mbledhjes me qëllim administrimin dhe mbarëvajtjen e punës.

Sa i përket të dhënave personale të mbledhura për kategorinë “punonjës”, Zyra e Komisionerit vlerëson se është i nevojshëm informimi paraprak.

Sipas deklarimeve të kontrolluesit dhe konstatimeve të Zyrës së Komisionerit, mbledhja e të dhënave personale të punonjësve arsimore, ka për qëllim të bëjë të mundur një organizim më efektiv të punës dhe rritjen e ndërveprimit, me synim arritjen e rezultateve më të larta në arsim.

Ndërsa përsa i përket, mbledhjes së të dhënave personale të nxënësve dhe të prindërve/kujdestarëve të tyre ligjore qëllimet e përpunimit kanë të bëjnë me:

- Forcimin e bashkëpunimit me komunitetin e prindërve për informimin e tyre në kohë reale lidhur me risitë dhe rritjen e cilësisë në arsim, në mënyrë që të jenë në kontakt të vazhdueshëm me ecurinë e nxënësve/lëmijëve të tyre dhe njohjen e risive të reja që sjell arsimi në vend;
- Rritjen e ndërveprimit mësues/prindër/nxënës mbi përmirësimin e mëtejshëm të arsimit;
- Ndjekjen e implementimit të risive arsimore nga prindërit, si dhe marrjen e mendimeve dhe opinioneve të tyre mbi ecurinë dhe përmirësimet e mëtejshme;
- Implementimin e sistemeve/aplikacioneve të reja për rritjen e këtij ndërveprimi dhe bashkëpunimi në kohë reale.

Kontrolluesi, gjatë procesit të hetimit por edhe në pretendimet e paraqitura gjatë seancës dëgjimore, ka deklaruar se mbledhja dhe përpunimi i këtyre të dhënave mbështetet në bazën ligjore në fuqi e cila është e publikuar në faqet zyrtare të MASR:

- Rregullorja e brendshme e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr.7457 Prot. datë 09.03.2017 (neni 36);
- Udhëzimi nr. 12 datë 27.04.2015 “Për mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve arsimore të institucioneve arsimore parauniversitare dhe të nxënësve, si dhe për përmbajtjen e dosjeve të tyre personale”;
- Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohen edhe detyrimi ligjor për mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve të sistemit arsimor dhe nxënësve (nenet 66 dhe 67);
- Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit, në lidhje me sa më sipër vlerëson se Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar parashikon në nenin 66 dhe 67, mundësinë e mbledhjes së të dhënave personale vetëm për kategoritë e subjekteve të të dhënave personale nxënës dhe punonjës të sistemit arsimor por, qëllimi i mbledhjes së të dhënave parashikuar në nenin 1 të këtij ligji është i ndryshëm nga qëllimet për të cilën janë shpërndarë formularët nëpër shkolla.

Ndërsa përsa i përket Udhëzimit nr. 12 datë 27.04.2015 “Për mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve arsimore të institucioneve arsimore parauniversitare dhe të nxënësve, si dhe për përmbajtjen e dosjeve të tyre personale”, Zyra e Komisionerit vlerëson se pavarësisht faktit që parashikon kategoritë e të dhënave personale që përpunohen për subjektet e të dhënave punonjës, nxënës, prind dhe qëllimet

e përpunimit të këtyre të dhënave, kjo nuk plotëson një nga kriteret ligjore kryesore të përpunimit të parashikuara në nenin 6 të ligjit nr. 9887, pasi akti që mund të legjitimojë një proces përpunimi të dhënash personale është vetëm në formën e ligjit. Gjithashtu, konstatohet se për kategorinë prind, në këtë akt, nuk parashikohet mbledhja e kategorisë së të dhënave personale “numër personal i identifikimit”.

Përpunimi i të dhënave personale legjitimohet vetëm nëse plotësohet një nga kushtet e sanksionuara në nenin 6 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit vlerëson se në mungesë të një parashikimi ligjor, kontrolluesi duhet të mbështetet në ekzistencën e pëlqimit si mundësi ligjore, referuar nenit 6 pika 1/a të ligjit, për të legjitimuar përpunimin e të dhënave personale. Pëlqimi, në bazë të nenit 3 pika 24 të ligjit, “*duhet të jetë në formën e një deklaratë me shkrim, i dhënë shprehimisht me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qenë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen, çka nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënat e tij*”.

Në kuadër të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në Ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, i ndryshuar, lidhur me implementimin e projektit rezultoi se kontrolluesi Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, gjatë procesit për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për këtë qëllim të ri, nuk ka parashikuar respektimin e parimit të mjaftueshmërisë së të dhënave personale, sanksionuar në nenin 5/1/c të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar, lidhur me përpunimin e kategorive të të dhënave personale “Numër personal të identifikimit”, për kategorinë e subjekteve të të dhënave personale “Prind/kujdestar ligjor”.

Zyra e Komisionerit, konstatoi se kontrolluesi Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, gjatë procesit të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave nëpërmjet formularëve, nuk ka marrë masa në drejtim të informimit të subjekteve të të dhënave personale, mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë dhe nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare, të parashikuara në nenin 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë, mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë si dhe me faktin nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare.

Është për t’u theksuar fakti se pas bërjes publike në media të çështjes së mbledhjes së të dhënave dhe në vijim të inspektimit të ushtruar nga Zyra e Komisionerit, kontrolluesi ka

reaguar menjëherë duke parashikuar në formular një paragraf informues lidhur me procesin:

“Të dhënat personale të mbledhura nëpërmjet këtyre formularëve do të përdoren me qëllim informimin e prindërve mbi çdo rezultat apo nismë arsimore. Plotësimi i këtyre formularëve bëhet me vullnet të lirë dhe nuk është i detyrueshëm. Përpunimi i të dhënave personale të mbledhura nëpërmjet këtyre formularëve do të kryhet në përputhje me ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar”.

Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi i subjekteve të të dhënave duhet të përfshihet në të gjithë formularët dhe të jetë më i plotë duke përfshirë të gjitha elementet e nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Në kuadër të zbatimit të nenit 21 të ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, nga verifikimi i njoftimit të kontrolluesit Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, rezultoi se nuk është përditësuar përmbajtja e tij sa i përket, Rubrikës 3 “Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen” për përfshirjen e kategorisë “Prind/kujdestar ligjor”, Rubrikës 6 “Qëllimi i përpunimit” për përfshirjen e qëllimeve të deklaruara, dhe Rubrikës 7 “Marrësit e të dhënave personale”.

Zyra e Komisionerit vlerëson se detyrimi për të përditësuar njoftimin nëpërmjet “Formularit të Njoftimit” është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi qëllimin e përpunimit të të dhënave që kryen kontrolluesi dhe të ushtrojnë në mënyrë korrekte të drejtat që u jep ligji.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin e hetimit administrativ (datë 21.05.2018), si dhe në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në datën 05.06.2018, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit, është mbajtur seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit, lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ.

Lidhur me pretendimet e paraqitura me shkrim nga kontrolluesi “Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë” mbi konstatimet e evidentuara nga grupi i inspektimit në procesverbalin e hetimit administrativ, Zyra e Komisionerit vlerëson angazhimin e këtij kontrolluesi për përmbushjen e detyrimeve ligjore, konkretisht:

- Hartimin dhe përfshirjen në formular të një paragrafi informues lidhur me procesin e përpunimit të të dhënave, në respektim të nenit 18 të Ligjit nr.9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar;
- Korrigjimin e standardeve të formularëve “Komiteti i prindërve për çdo shkollë” dhe “Prindërit për çdo shkollë”, duke hequr kategorinë e të dhënave personale “Numër personal të identifikimit”, për kategorinë e subjekteve të të dhënave personale “Prind/kujdestar ligjor”;

- Tërheqjen e të gjithë formularëve të parë, të shpërndarë në njësitë arsimore vendore, me qëllimin për të mos sjellë asnjë pasojë apo dëm për kategorinë e subjekteve të të dhënave personale “Prind/kujdestar ligjor”.

Këto ndryshime janë evidentuar nëpërmjet një emaili të dërguar nga përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë drejtuar Drejtorëve të DAR/ZA, që mban datën 04.05.2018.

Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e kontrolluesit me grupin e kontrollit administrativ. Në vijim kontrolluesi është angazhuar në përmbushjen e detyrimeve ligjore.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5/1/c, 6/1/a, 18, 21, 27, 29, 30 dhe 31/1, gërma a/1 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në zbatim të nenit 5/1/c të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të ketë në vëmendje parimin e mjaftueshmërisë, duke mbledhur dhe përpunuar ato të dhëna që lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim.
2. Nëse nga DAR/ZA në nivel lokal janë mbledhur të dhëna personale mbi “numrin personal të identifikimit” për kategorinë e subjektit “Prind/Kujdestar ligjor”, nëpërmjet formularëve “Komiteti i prindërve për çdo shkollë” dhe “Prindërit për çdo shkollë”, kontrolluesi Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të realizojë shkatërrimin e tyre, brenda një afati 10 ditor, nga momenti i marrjes dijeni, pasi përpunimi i tyre konsiderohet në tejkallim të qëllimit të përpunimit;
3. Kontrolluesi Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në zbatim të nenit 6 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të ketë në vëmendje kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave, duke marrë pëlqimin e subjekteve të të dhënave për qëllimin e ri të përpunimit sipas pjesës arsyetuese të këtij Rekomandimi.
4. Kontrolluesi Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr.9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të marrë masa në drejtim të plotësisimit të informimit nëpërmjet përfshirjes në formular të të gjithë elementeve informues, mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë subjektet, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë dhe nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare.
Në rubrikën mbi “Politikat e Privatësisë” të publikuar në faqen zyrtare në internet të Ministrisë, të përfshihen edhe elementet informues për këtë përpunim të ri, në referim

